



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
**DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/ \_\_\_\_/ 2016

**Lënda:** Dërgohet mendim për projekt-ligjin "Për Mbrojtjen e Sinjalizuesve"

**Drejtuar:** **Z. Fatmir Xhafaj**  
Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut  
**KUVENDI I SHQIPËRISË**

**TIRANË**

I Nderuar Kryetar,

Në përgjigje të kërkesës Tuaj, për parashtrimin e mendimeve lidhur me projekt-ligjin "Për Mbrojtjen e Sinjalizuesve", po ju parashtrojmë si më poshtë mendimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për këtë projektligj:

Në nenin 3, pika 5 të projektligjit parashikohet shprehimisht se: *"Hakmarrje", çdo veprim i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë apo kërcënim, i kryer nga organizata me natyrë diskriminuese, disiplinore ose që, në një formë tjetër, të padrejtë, dëmton interesat e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi".*

Sa më lart, mendojmë që kësaj pike mund ti shtohet një paragraf, dhe neni 3 pika 5 të kishte përmbajtjen e mëposhtme:

*"Hakmarrje" është çdo veprim, i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë apo kërcënim, i kryer nga organizata, me natyrë diskriminuese, disiplinore ose që, në një formë tjetër, të padrejtë, dëmton interesat e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi.*

*Veprimi, i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, me natyrë diskriminuese, sipas përkufizimit të mësipërm, duhet të kuptohet/interpretohet në përputhje me nenin 3 të Ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".*



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## Shpjegim:

Duke qenë se Ligji "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*" jep përkufizimet mbi diskriminimin dhe format e shfaqjes së tij dhe ky projektligj e përkufizon "Hakmarrjen" si veprim diskriminues, mendojmë se ky koncept duhet të kuptohet dhe të implementohet në harmoni me përkufizimet dhe standartet e ligjit "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", si ligj i cili është i harmonizuar me standartet europiane, konkretisht katër Direktiva të BE në fushën e mos-diskriminimit.

Në këtë mënyrë, miratimi i legjislacionit të ri do të jetë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi. Mendojmë se shtimi i paragrafit të dytë në përkufizimin e hakmarrjes, sipas projekt-ligjit "*Për Mbrojtjen e Sinjalizuesve*", nuk do linte vend për boshllëqe dhe hapësira interpretimi për termin "*veprime diskriminuese*" kur tashmë kemi një ligj të posaçëm në fushën e diskriminimit dhe gjithashtu është i rëndësishëm për një kuptim më të mirë të këtij përkufizimi dhe implementimit të tij me standarte të harmonizuara.

**KOMISIONERI**

---

**Irma BARAKU**



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)